Qendra Burimore "Ana" – Profili

Mbështetje e hershme. Ndikim gjatë gjithë jetës.

19 mars 2026

Rreth Inkluzionit

Inkluzioni është një organizatë e shoqërisë civile në Kosovë që punon për të avancuar edukimin gjithëpërfshirës, përfshirjen sociale, standardet e komunikimit të qasshëm dhe mundësitë e barabarta për grupet e cenueshme dhe të margjinalizuara, veçanërisht për fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët me vështirësi në të folur dhe komunikim, si dhe për ata që përballen me vështirësi psikologjike ose emocionale. Përmes programeve të bazuara në komunitet, shërbimeve rehabilituese, avokimit dhe ngritjes së kapaciteteve profesionale, Inkluzioni bashkëpunon ngushtë me institucionet arsimore, familjet dhe autoritetet publike për të përmirësuar qasjen në shërbime të specializuara dhe për të forcuar sistemet gjithëpërfshirëse në të gjithë Kosovën. Gjatë viteve, organizata ka qenë pioniere e disa iniciativave në Komunën e Gjilanit, përfshirë vendosjen e asistentëve për fëmijë me aftësi të kufizuara në shkolla dhe integrimin e shërbimeve të terapisë së të folurit brenda institucioneve edukativo-arsimore.

Qendra Burimore "Ana"

Qendra Burimore "Ana" është një qendër e specializuar shërbimesh e dedikuar për mbështetjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara, fëmijëve me vështirësi në të folur, gjuhë dhe komunikim, si dhe fëmijëve që përballen me trauma apo sfida të tjera psikologjike dhe psikosociale. Qendra gjithashtu ofron mbështetje për anëtarët e familjes, prindërit dhe kujdestarët, duke njohur rolin thelbësor të tyre në zhvillimin dhe mirëqenien e fëmijëve. Qendra është themeluar në janar 2026 nga organizata Inkluzioni në Gjilan dhe përfaqëson kulmin e disa viteve pune praktike, përvoje në terren dhe identifikimi të nevojave përmes programeve të bazuara në komunitet të zbatuara nga Inkluzioni në sektorin e arsimit.

Themeli i Qendrës ndërtohet mbi disa vite përvojë praktike dhe iniciativa programore të zbatuara nga Inkluzioni në sektorin e arsimit. Kjo përfshin iniciativën e hershme gjatë viteve 2017–2018 për të vendosur për herë të parë asistentë të mësimdhënies në institucionet arsimore në Gjilan, përfshirë shkollat fillore dhe institucionet parashkollore, me qëllim të forcimit të mbështetjes për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe vështirësi në të nxënë brenda klasave gjithëpërfshirëse. Duke u mbështetur në këto përpjekje, gjatë viteve 2022–2023 Inkluzioni ka zbatuar ndërhyrje intensive të terapisë së të folurit në disa nga shkollat kryesore fillore në Gjilan, përfshirë *"Thimi Mitko", "Selami Hallaqi", "Musa Zajmi" dhe "Abaz Ajeti"*. Këto shërbime janë realizuar me mbështetjen e Ambasadës së Zvicrës në Kosovë,

Ambasadës së Shteteve të Bashkuara në Kosovë, Komunës së Gjilanit dhe Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF), duke arritur një numër të konsiderueshëm të fëmijëve me nevoja të paplotësuara në komunikim.

Duke e zgjeruar më tej qasjen e saj, në periudhën shtator–dhjetor 2025, Inkluzioni pilotoi për herë të parë shërbime të ndërhyrjes së hershme në fëmijëri, duke u fokusuar në institucionet parashkollore dhe mjediset e hershme të të nxënit. Me mbështetjen e Komunës së Gjilanit, shërbimet u ofruan në pesë institucione parashkollore *("Ardhmeria 1", "Ardhmeria 2", "Integer", "Dardania" dhe "Agim Ramadani" në Zhegër*) si dhe në dy shkolla fillore me klasa parashkollore *("Rexhep Elmazi" dhe "Agim Ramadani" në Zhegër)*. Brenda një periudhe të shkurtër të zbatimit, u identifikuan 250 fëmijë me vështirësi në të folur dhe komunikim dhe u realizuan mbi 1,000 seanca të terapisë së të folurit — duke theksuar si përmasën e nevojës ashtu edhe urgjencën për shërbime të qëndrueshme dhe afatgjata.

Pavarësisht këtyre përpjekjeve, një numër i madh i fëmijëve të cenueshëm mbetën pa qasje në mbështetje të specializuar. Në përgjigje të kësaj nevoje, Inkluzioni themeloi Qendrën Burimore "Ana" si një zgjidhje të dedikuar dhe të bazuar në komunitet. E vendosur në zemër të qytetit të Gjilanit, Qendra operon në një hapësirë prej 300 m² e ofruar pa qira përmes një marrëveshjeje afatgjatë, duke dëshmuar përkushtim të fortë institucional dhe qëndrueshmëri.

Qendra mban emrin e *Anës, një vajze 17-vjeçare të diagnostikuar me autizëm,* historia e jetës të së cilës dhe *përkushtimi i jashtëzakonshëm i nënës së saj* kanë frymëzuar thellësisht punën e Inkluzionit. Rruga e Anës ka ndikuar drejtpërdrejt në dizajnimin dhe zhvillimin e programeve gjithëpërfshirëse, duke vendosur familjet dhe sfidat reale të jetës në qendër të ofrimit të shërbimeve.

Që nga funksionalizimi i plotë në shkurt 2026, Qendra Burimore "Ana" ofron shërbime të vazhdueshme të terapisë së të folurit përmes një ekipi prej tre terapistësh profesionalë të të folurit. Aktualisht, Qendra mbështet 18 fëmijë me rreth 200 seanca terapie në muaj, ndërsa një numër shtesë fëmijësh - më shumë se dyfishi i kapacitetit aktual - mbeten në listën e pritjes.

Qendra luan një rol kritik në lehtësimin e barrës financiare për familjet. Në klinikat private, një seancë e vetme e terapisë së të folurit kushton rreth 20 EUR, ndërsa fëmijët zakonisht kanë nevojë për 2–3 seanca në javë (40–60 EUR në javë për një fëmijë). Shumë familje përballen me sfida të shumëfishta, veçanërisht ato që kanë më shumë se një fëmijë në nevojë për terapi. Me kapacitetin aktual, Qendra Burimore "Ana" kursen për familjet rreth 4,000 EUR në muaj, duke mbështetur drejtpërdrejt familjet që jetojnë në kushte të vështira socio-ekonomike.

Të gjithë fëmijët që përfitojnë nga shërbimet e Qendrës vijnë nga familje me mundësi të kufizuara financiare dhe me nevojë urgjente për mbështetje të specializuar. Qendra është e pajisur plotësisht me materiale didaktike, mjete për terapinë e të folurit dhe teknologji ndihmëse, kryesisht me mbështetjen e Komunës së Gjilanit dhe njerëzve të vullnetit të mirë.

Edhe pse Qendra Burimore "Ana" tashmë ka demonstruar ndikim të rëndësishëm në një periudhë të shkurtër kohore, kapacitetet e saj aktuale mbeten të kufizuara në krahasim me kërkesën në rritje. Mbështetja e vazhdueshme është thelbësore për të ruajtur funksionimin e saj, për të zgjeruar shërbimet dhe për të siguruar që më shumë fëmijë me vështirësi në të folur

dhe komunikim të kenë qasje në kujdesin e specializuar që u nevojitet për zhvillimin, përfshirjen dhe mirëqenien e tyre.

Kontakti:
Qendra Burimore "Ana"
Koordinatore: Altina Mehmeti
E-mail: info@inkluzioni.org
Phone: +38349355400